

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“CYBER MORFOSIS” SHPK

Sot, më datë 15/03/2024, ortaku si më poshtë:

- Znj. Edlira Martiri**, shtetas shqiptare, lindur me 06.04.1980, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit nr. 033451000 dhe nr. personal I05406056F;

Vendosën të hartojnë këtë Akt Themelimi, me përmbajtje si më poshtë:

NENI 1
DATA E THEMELIT

Sot, më datë 15/03/2024, themeluesi Edlira Martiri vendosi të krijojë një shoqëri me emërtimin “CYBER MORFOSIS” SHPK.

NENI 2
FORMA E SHOQËRISË

Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

NENI 3
EMËRTIMI

Emri i plotë i shoqërisë është “CYBER MORFOSIS” shpk.

NENI 4
SELIA

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Rr. “Emin Harizaj”, Lagjia 1, Pallati 10, Ap. 6, Njësia Bashkiake 1, Tiranë.

Me miratim të organeve të saj, shoqëria mund të ndryshojë selinë, mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

NENI 5
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së



Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

NENI 6 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria “CYBER MORFOSIS” shpk do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

Ofron shërbime që përfshijnë zhvillimin e produkteve IT, faqeve ueb, sigurisë së informacionit, trajnime, menaxhimin e rrezikut, zhvillimin e politikave IT, pajtueshmërinë ligjore dhe IT, konsulencën, mbështetjen teknike dhe zgjidhje të avancuara IT. Trajnime të specializuara për ekzekutivë, punonjës dhe zhvillues IT për të rritur ndërgjegjësimin dhe vendimmarrjen në fushën e sigurisë kibernetike. Module të personalizuara sipas kërkesës, duke përfshirë tema si Menaxhimi i Rrezikut dhe përputhshmëria me GDPR si dhe kuadro ligjore standarte; Shërbimet e Menaxhimit dhe Vlerësimit të Rrezikut; Vlerësime të sigurisë, identifikim i gjithëpërfshirë të rrezikut, menaxhimi i punonjësve lidhur me sigurinë kibernetike, vlerësim dhe skenarë rreziku; Konsulencë që mbulon politikën kyçe të sigurisë kibernetike, zhvillimi i politikave të brendshme në përputhje me standardet ISO, SOC2, GDPR, PCI-DSS, etj. dhe personalizimi i kontrollimeve të sigurisë. Konsulencë për auditim IT dhe strategji; kërkim tregu në fushat e IT, menaxhimin e projekteve dhe zhvillimin e produkteve; menaxhimi i identiteteve, sistemet biometrike, implementimi i sistemeve blockchain, migrimi në cloud, zgjidhjet e infrastrukturës PKI, trajnime dhe testimi i të dhënave ML dhe AI, dhe gjenerimi dhe implementimi i të dhënave sintetike.

NENI 7 KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10.000 (dhjetë mijë) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortaku si më poshtë:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Vlera e Pjesmarrjes
Edlira Martiri	100 %	1	10,000 (Lek)

Ky kapital është i ndarë në 1 (një) kuot e zotëruar nga një ortak.

Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

NENI 8 ADMINISTRATORI

Administratori i parë i shoqërisë “CYBER MORFOSIS” shpk do të jetë:



Administrator i parë i shoqërisë do të jetë **Znj. Edlira Martiri**, shtetas Shqiptar, lindur më 06.04.1980 në Shkodër dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit nr. 033451000 dhe nr. personal I05406056F.

Kohëzgjatja e mandatit të tij është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9
DISPOZITAT E FUNDIT

Ky akt themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.
Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapokrijuar, gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkangjitur.
Autorizohet Administratori Znj. Edlira Martiri për të kryer veprimet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

THEMELUESIT

EDLIRA MARTIRI

